KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në urdhrin e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 739, datë 15.12.2022, "Për miratimin e rregullores 'Për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë"', publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë. 11.1.2023, bëhet korrigjimi në si më poshtë vijon:

Neni 33 nga pika 3 deri në pikën 14 ishte:

"3. Për moszbatim të shkronjës "r" të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa "Vërejtje".

4. Për moszbatim të shkronjave "b", "e", "f" "h", "i", "j", "m", "n", "o" dhe "p" të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa "Paralajmërim për largim nga puna". Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

5. Për moszbatim të shkronjave "c", "d", "k", "g", "l" dhe "q" të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa "Largim nga puna". Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

6. Për moszbatim të shkronjave "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h", "i", "l", "m", "n", "o", "p", "q" dhe "r" të pikës 4, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorit të provimit, merret masa "Vërejtje". Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

7. Për moszbatim të shkronjave "a", "j", "k", dhe "s" të pikës 4 të nenit 22 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të provimit, masa "Largim nga puna" në rastin e mësuesve, masa të cilat pasqyrohen në librezën e punës.

8. Për moszbatim të shkronjës "f", "h" të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa "Vërejtje".

9. Për moszbatim të shkronjave "b", "c", "e", dhe "g" të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa "Paralajmërim për largim nga puna". Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

10. Për moszbatim të shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 23 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa "Largim nga puna".

11. Për moszbatim të shkronjave "e" , "g" dhe "h", të pikës 2, të nenit 24 të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa "Vërejtje".

12. Për moszbatim të shkronjës "d", "f" të pikës 2, të nenit 24 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa "Paralajmërim për largim nga puna". Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

13. Për moszbatim të shkronjave "c", dhe "i" të pikës 2 të nenit 24 të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa "Largim nga puna". Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

14. Për moszbatim të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 21, pikave 2 dhe 3 të nenit 22, shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 23 dhe shkronjës "b", të nenit 24, ndaj drejtorit të zyrës arsimore vendore merret masa "Largim nga detyra", nga titullari përkatës. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.".

Neni 33 nga pika 3 deri në pikën 14 bëhet:

"3. "Për moszbatim të shkronjës "q" të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa "Vërejtje".

4. Për moszbatim të shkronjave “b”, “e”, “f” “h”, “i”, “j”, “m”, “n” dhe “o”, të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

5. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d”, “k”, “g”, “l” dhe “p”, të pikës 2, të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

6. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “l”, “m”, “n”, “o”, “p”, “q” dhe “r” të pikës 2 të nenit 22 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorit të provimit, merret masa “Vërejtje”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

7. Për moszbatim të shkronjave “a”, “j”, “k” dhe “s” të pikës 2, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të provimit, masa “Largim nga puna” në rastin e mësuesve, masa të cilat pasqyrohen në librezën e punës.

8. Për moszbatim të shkronjave “f” dhe “g” të pikës 3, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Vërejtje”.

9. Për moszbatim të shkronjave “b”, “d”, “e” dhe “g” të pikës 3 të nenit 23 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

10. Për moszbatim të shkronjës “c” të pikës 3, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Largim nga puna”.

11. Për moszbatim të shkronjave “d”, “f” dhe “g” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Vërejtje”.

12. Për moszbatim të shkronjës “e” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

13. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “h” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

14. Për moszbatim të pikës 3 të nenit 21, pikës 1 dhe 3 të nenit 22, të pikës 1 të nenit 23 dhe shkronjës “b” të, pikës 2, të nenit 24, ndaj drejtorit të zyrës arsimore vendore merret masa “Largim nga detyra”, nga titullari përkatës. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.”.